

## INFORMATATA MBI GRANTIN

<b>Instrumenti:</b>	Grant Institucional
<b>Subjekti zbatues:</b>	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
<b>Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):</b>	Rr. Rexhep Luci, 16/1, Prishtinë <a href="mailto:office@legalpoliticalstudies.org">office@legalpoliticalstudies.org</a> +383 (38) 234 456 <a href="http://www.legalpoliticalstudies.org">www.legalpoliticalstudies.org</a>
<b>Kohëzgjatja e grantit:</b>	Data e fillimit: 01/03/2026 Data e përfundimit: 31/12/2028
<b>Buxheti i përgjithshëm i organizatës (EUR):</b>	EUR 1,351,162.60
<b>Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):</b>	EUR 113,940.00
<b>Grupet e synuara:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Publiku i gjerë</li><li>▪ Institucionet publike, përfshirë por pa u kufizuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, Ministrinë e Drejtësisë dhe agjencitë përkatëse</li><li>▪ Të rinjtë</li><li>▪ Gratë</li><li>▪ Grupet e tjera të marginalizuara</li></ul>
<b>Shtrirja gjeografike:</b>	Gjithë Kosovën
<b>Përmbledhje e grantit:</b>	Përmes mbështetjes nga granti institucional, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) synon të forcojë kapacitetet e tij në fushën e sundimit të ligjit duke vazhduar zhvillimin dhe avancimin e nismës së tij kryesore – Indeksit të Performancës së Sundimit të Ligjit në Kosovë (RoLPIK), një instrument monitorues i bazuar në të dhëna i themeluar në vitin 2015. Kjo mbështetje synon të kontribuojë në promovimin e një sistemi të sundimit të

Bashkëfinancuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Suedia  
Sverige



	<p>ligjit më transparent, më llogaridhënës dhe më të orientuar drejt qytetarëve.</p> <p>Gjatë zbatimit të grantit, GLPS do të vazhdojë publikimin e edicioneve të rregullta të RoLPIK dhe do të lansojë Revistën “Rule of Law Observer”, e cila do të shërbejë si platformë për analiza, reflektime dhe diskutime mbi zhvillimet në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë. Përveç kësaj, organizata do të zhvillojë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal, duke transferuar njohuri dhe praktika të monitorimit dhe avokimit nga instrumente ekzistuese si CorrWatch, Justice Today dhe Just React, me qëllim zgjerimin e mbikëqyrjes së nxitur nga qytetarët edhe në nivel komunal.</p> <p>Përmes kësaj mbështetjeje institucionale, GLPS synon të konsolidojë më tej rolin e tij si një think-tank i pavarur dhe lider në Kosovë, duke forcuar lidhjen ndërmjet qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve publike.</p>
--	--